



PUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE
TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 4529/prot.
1

Tiranë, më 10.04.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. Nr.1340, datë 11.05.2009.

SHOQËRISË “INFO METAL PLAST” SH.P.K
Nish Tulla, Durrës

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “INFO METAL PLAST” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1340, datë 11.05.2009, për mineralin krom, në Objektin “Bregu i Skatinës – dalja 1”, Bashkia Has, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 2581, datë 23.06.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 4529 Prot., datë 25.06.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1340, datë 11.05.2009, për mineralin krom, në Objektin “Bregu i Skatinës – dalja 1”, Bashkia Has, Qarku Kukës, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet minerar prej më shumë se një viti.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1340, datë 11.05.2009, për mineralin krom, në Objektin “Bregu i Skatinës – dalja 1”, Bashkia Has, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1340, datë 11.05.2009, për mineralin krom, në Objektin “Bregu i Skatinës – dalja 1”, Bashkia

Has, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

CENO KLOSI

